



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1084_01_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 12.02.2014.

në seancën e mbajtur më datë 12 mars 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin H.B., me shifër të konsumatorit: DFE – 11694) nga Ferizaj ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1084_01_14 i datës 17.01.2014.

Arsyetim

Me datë 16.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse te konsumatori, ku kanë konstatuar se sipas kërkesës së konsumatorit kanë dal në vend dhe kemi vërejtur se konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe me këtë rast kemi bllobuar njehsorin e ri. Konsumatori nuk ka prezantuar njehsorin e vjetër me numër 17729345 gjithashtu është theksuar se duhet t'i bëhet ndërrimi dhe legalizimi i njehsorit elektrik.

Me datë 16.01.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dal te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 17729345 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 4940548, ku kanë theksuar se ky njehsor duhet të shkoj në shqyrtim dhe verifikim.

Me datë 14.08.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 17729345, ku është konstatuar se njehsori elektrik bllobat shtetërore i ka të këputura, dhe të manipuluar të hapura dhe prapë të mbyllura, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime tjera nuk ka numëruesi i njehsorit është i manipuluar, ka gjurmë të kthimit mbrapa të numrave në numëror .

Me datë 24.01.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DFE08HP03800 në vlerë prej 2,251.47€.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 06.01.2009 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kundërshtuar shfrytëzimin e



paautorizuar te energjisë elektrike. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 17.01.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar nga KKDFE që: KKDFE duhet të shkarkojë konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DFE08HP03800 të datës 24.01.2008 në vlerë prej 2,251.47 €.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se në procesverbalin e kalibrimit nr. 7/14 të datës 14.08.2008 gjendja e njehsorit ka qenë e shënuar T1=007792 kWh dhe T2=003543 kWh, është një gabim teknik te përgjegjësit e kalibrimit.

Gjithashtu sa i përket llogaritjes çdo gjë është bërë në bazë të Procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit te paautorizuar te energjisë elektrike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12 mars 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës e posaçërisht procesverbalit të kalibrimit është vlerësuar se konstatimet e prezantuara janë shumë kontradiktoret pasi që në procesverbalin e kontrollës së KEK-ut të datës 16.01.2008 punëtorët e autorizuar të kontrollës kanë theksuar se konsumatori ka bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe se konsumatori nuk prezanton njehsorin e vjetër, ndërsa në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik te shënimet e njehsorit të vjetër është evidentuar vetëm gjendja e njehsorit elektrik e cila në momentin e ndërrimit ka qenë: TL=25096 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=36310 kWh (tarifa e ulët). Në procesverbalin e qendrës së kalibrimit nr. 7/14 të datës 14.08.2008 gjendja e njehsorit elektrik është TL=007792 kWh dhe TU=003543 kWh, por që kjo gjendje nuk përputhet me gjendjen e rrjedhës së energjisë elektrike, vërtetimit të ndërrimit të njehsorit elektrik dhe fotografitë e kalibrimit. Po ashtu duhet theksuar se edhe gjendja e evidentuar në rrjedhën e energjisë elektrike në muajin 01/2008 nuk përputhet me gjendjen e evidentuar në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit elektrik dhe atë të fotografive të kalibrimit, e posaçërisht nuk përputhet gjendja e tarifës së ulët, ngase siç u theksuar më lartë gjendja e njehsorit elektrik në vërtetimin e ndërrimit të njehsorit dhe fotografitë e kalibrimit ka qenë: TL=25096 kWh dhe TU=36310 kWh, ndërsa në rrjedhën e energjisë elektrike aktive është: TL=25090 kWh dhe TU=35996 kWh.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar edhe rrjedhën e energjisë elektrike të konsumatorit për të vërtetuar edhe gjendjen e shpenzimit të energjisë elektrike para dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik dhe pas këtij verifikimi ka konstatuar se gjendja e shpenzimit të këtij konsumatori për sezona është paraqitur në vijim.

Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës së lartë (dimërore) me njehsor të vjetër nr. 17729345 për periudhën 10/2004 – 03/2005 është 1385 kWh/muaj, për periudhën 10/2006 – 03/2007 është 951 kWh/muaj, ndërsa me njehsor të ri nr. 4940548 për periudhën 10/2010 – 03/2011 është 998 kWh/muaj, për periudhën 10/2012 – 03/2013 është 663 kWh/muaj.

Mesatarja e shpenzimit të energjisë elektrike gjatë sezonës së ulët (verore) me njehsor të vjetër nr. 17729345 për periudhën 04/2004 – 09/2004 është 548.67 kWh/muaj, për periudhën 04/2005 – 09/2005 është 942.33 kWh/muaj kurse me njehsor të ri nr. 4940548 për periudhën 04/2012– 09/2012 është 485.00 kWh/muaj, për periudhën 04/2013– 09/2013 është 425.50 kWh/muaj. Nga ky konstatim del se ky konsumator nuk ka indice të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike pasi që te ky konsumator mbas ndërrimit të njehsorit elektrik kemi vetëm rënje të shpenzimit për 24%.

Mbështetur në nenin 8 paragrafi 8.3 të Rregullës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar te energjisë elektrike theksohet: *“Konstatimet e parregullsisë funksionale të njehsorit elektrik siç përcaktohet në nenin 3 paragrafi i) të konstatuara në laboratorin e kalibrimit nuk mund të përdoren si provë e vetme meritore për ngarkimin e konsumatorit me faturën e rikthimit të energjisë së humbur”*.



Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KEDS se llogaritja e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike është bërë në përputhje të plotë me Procedurën e përkohshme për shfrytëzimin dhe parandalimin e paautorizuar të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës ka konstatuar se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për zbatimin e kësaj procedure, pasi që nga KEDS nuk ka vërtetuar gjendjen faktike për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike, andaj KEDS me rastin e vendosjes së kësaj çështje ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KKDFE në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.03.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1084_01_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar